




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr Prot. Br Prot. 01-1653/15
Nr. l faq. Broj stranica 02	Data Datum 24.06.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	24.06.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Gëzim ShALA Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Spitalin e Ferizajt
CC:	z. Besnik AHMETI Drejtor i Shërbimit të Shëndetit Mendor-Shtime
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderët “Furnizimi dhe vendosja e shenjzimeve, kamerave në QIRSPK – Shtime” dhe “Rregullimi i autoambulancës (e akcidentuar) në QIRSKP-Shtime”



I nderuari z. Shala,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderët **“Furnizimi dhe vendosja e shenjzimeve, kamerave në QIRSPK – Shtime”** me numër prokurimi 712 2015 015 136 dhe **“ Rregullimi i autoambulancës (e akcidentuar) në QIRSKP- Shtime”** me numër prokurimi: 712 2015 016 236 Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderët **“Furnizimi dhe**

vendosja e shenjzimeve, kamerave në QIRSPK – Shtime” me numër prokurimi 712 2015 015 136 dhe “ Rregullimi i autoambulancës (e akcidentuar) në QIRSKP- Shtime” me numër prokurimi: 712 2015 016 236 , në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Shërbimi i Shëndetit Mendor si Autoritet Kontraktues, përmes Zyrës për Prokurim ka përgatitë njoftimet për kontratë me titull “**Furnizimi dhe vendosja e shenjzimeve, kamerave në QIRSPK – Shtime**” me numër prokurimi 712 2015 015 136 dhe “ **Rregullimi i autoambulancës (e akcidentuar) në QIRSKP- Shtime**” ,të cilat janë publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.18.06.2015. Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar këtë procedurë të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit ka hasur në të dhëna të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimet për kontratë të cilat janë publikuar në faqen elektronike të KRPP-së, me datë 18.06.2015 tek rubrika III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, **ka kërkuar: Referenca përvoja eksperiencia e kompanisë** kërkesë e cila konsiderojmë se bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Bazuar në legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik, një Autoritet Kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë si dëshmi referenca me të cilat do ta vërtetonte Kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomik, mirëpo nëse e vendos një kërkesë të tillë, për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-ve, atëherë detyrimsht këto referenca duhet ti kërkojë në tri vitet e fundit (2012,2013 dhe 2014) . Autoritetit Kontraktues nuk i lejohet në asnjë mënyrë që ti shmanget këtij kufizimi prej tri viteve.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin **69** Aftësia Teknike dhe Profesionale të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042,dhe nenin **23** Kriteret e Përzgjedhjes të Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla, nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj AKK rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !